

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITSHME JURIDIKE E ASETVE DHE LICENSIMIT
DREJTORIA E LICENSIMIT DHE GJENDJES CIVILE

NJOFTIM

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1096, “ Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe manazhimin e hapësirës publike”, vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 158, datë 26.12.2019 për “Miratimin e Sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës“ (i ndryshuar), si dhe në zbatim të nenit 40, të Vendimit nr.130, datë 15.11.2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”, i ndryshuar, Bashkia Tiranë cdo fillim viti shpall numrin e vendeve të lira në tregjet publike si më poshtë:

Në tregun pranë “Pazarit të Ri”, Njësia Administrative Nr.3,	116 vende
Në tregun pranë rrugës “Petro Nini Luarasi”, Njësia Administrative Nr.2,	52 vende
Në tregun pranë rrugës “4 Dëshmorët”, Njësia Administrative Nr.3,	34 vende
Në tregun publik të rrobave të përdorura ne zonën e Shkozës,	106 vende
Në tregun publik të rrobave të përdorura midis rrugës “Hamdi Pepa dhe “Mustafa Haska”	98 vende

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

- Deklaratë e përgjegjësisë së aplikuesit;
- NIPT/ Fotokopje e leternjoftimit ID;
- Planvendosja me vendndodhjen/et e tregtimit firmosur dhe vulosur nga person i licencuar në këtë fushë (e vlefshme për tregjet);
- Skica ose projekt të pajisjes për njësinë e tregtimit ambulant;
- Librezën shëndetsore në rastet e tregtimit të mallrave ushqimor (fotokopje e noteruar);
- Lista e produkteve merceologjike;
- Si dhe cdo dokument tjetër bazuar në VKB.

Në miratimin e kërkesës për plotësimin e vendeve të tregtimit në këto tregje do të ndiqen në mënyrë transparente plotësimi i kushteve nga çdo aplikant. Në vleresim/kualifikim u jepet përparësi në radhë rëndësie: (i) plotësimi të dokumentave të kërkuar, (ii) datës së paraqitjes të kërkesës (e para hyn e para del), (iii) vjetërsisë në ushtrimin e tregtisë në atë treg ose (iv) si ambulant.

Funksionimi i tregut

- Aktiviteti i tregjeve dhe vendndodhjes së shitjes ambulante zhvillohet në të gjitha ditët e javës. Me akte të Kryetarit të Bashkisë nëse lind nevoja mund të përcaktohet dita pushim në tregun fiks. Më kërkesë të subjektit të interesuar mund të përcaktohet dita pushim për vendndodhjen e shitjes ambulante.
- Bashkë me përcaktimin e vendeve Bashkia harton edhe kalendarin dhe rregulloren funksionimit për secilin treg fiks apo të lëvizshëm.
- Orari i shitjes në treg dhe për vendndodhjen e shitjes ambulante përcaktohet në leje dhe mund të zgjas nga ora 6.00 deri në orën 20.00.
- Përgatitja për vendosjen e pajisjeve fillon 90 min përpara fillimit të funksionimit të tregut dhe hapësira e zënë duhet të lihet e lirë brenda 60 min nga përfundimi i orarit të tregtimit.
- Tregtarët janë të detyruar të zbatojnë në mënyrë rigoroze orarin si më sipër. Nuk lejohet braktisja e tregut brenda kohëzgjatjes së orarit të përcaktuar.
- Përcaktimi i një dite në javë, si ditë pushimi do të bëhet me kërkesë të vetë subjektit dhe/ose me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Mallrat që do të tregtohen dhe vendi i tregtimit

- Hapësira e tregut ndahet sipas sektorëve merceologjikë dhe mbi këtë bazë bëhet edhe caktimi i vendeve për secilin tregtar.
- Tregtarët janë të detyruar të nxjerrin në shitje vetëm artikujt e planifikuar për sektorin të cilit i përkasin, gjë e cila është e përcaktuar në lejen përkatëse të Bashkisë.
- Nuk lejohet ekspozimi dhe shitja në të njëjtin vend e mallrave industriale dhe atyre ushqimore.
- Në vendndodhjet e shitjes ambulante mund të tregtohen kryesisht produkte ushqimore të përpunuara, kinkaleri, lule, produkte duhani, artikuj të përdorur.
- Tregtarët ambulante që kryejnë aktivitetin në këto tregje duhet të mbajnë parasysh kushtet e përcaktuara si më poshtë:
 - Të mos zënë sipërfaqe më të mëdha apo të ndryshme nga ajo e përcaktuar në lejen e lëshuar.
 - Mallrat duhet të ekspozohen në banakë në një lartësi minimale nga trualli prej 0,5 m dhe pjesa e poshtme e mbulesës (tendat) duhet të jenë të paktën 2 m nga trualli.
 - Mbulesa duhet të jetë e sigurtë dhe në asnjë rast nuk duhet të kalojë hapësirën që i është caktuar subjektit.
 - Lejohet ekspozimi direkt në truall i artikujve industrial të tillë si pajisje elektroshhtëpiake, mobilje, poçeri, lule e vazo e ndonjë tjetër që kushtet e kërkojnë një tregim të tillë.
- Me qëllim që të garantohet një zhvillim sa më normal i tregut, në të nuk lejohet përdorimi i asnjë lloj aparati amplifikimi, përjashtuar tregtarët e produkteve audio-vizive. Këto të fundit duhet të kenë parasysh mbajtjen e volumit të zërit brenda limiteve që nuk i sjellin shqetësim pjesëmarrësve dhe frekuentuesve të tregut.

Afishimi i çmimeve

Është i detyrueshëm afishimi i çmimeve të shitjes. Tregtari në mënyrë të dukshme duhet të afishojë etiketat e çmimeve të mallrave të ekspozuara për shitje.

Kontrolli higjieno-sanitar

Tregtimi i artikujve ushqimorë i nënshtrohet mbikqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve shëndetsore. Të gjithë tregtarët duhet të jenë të pajisur me librezë shëndetësore. Ata duhet t'i nënshtrohen të gjitha kontrolleve periodike dhe të respektojnë të gjitha rregullat e nxjerra nga organet kompetente.

Pastrimi

1. Pastrimi i përgjithshëm i tregut apo i vendndodhjes së shitjes ambulante do të kryhet nga Bashkia e Tiranës në përfundim të orarit tregtimin, pas heqjes së pajisjeve dhe largimit të tregtarëve.
2. Njëkohësisht është e detyrueshme për çdo tregtar mbajtja pastër e vendit të tregtimin. Ata në asnjë rast nuk duhet të hedhin përtokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojnë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.

Shkeljet

1. Përvec shkeljeve të përcaktuara në VKB nr.130, date 15.11.2018, i ndryshuar, për shkak të specifikave të aktivitetit konsiderohen shkelje dhe rastet në vijim:
 - Shkelja e rregullave të përcaktuara për tregtimin në këto tregje sipas këtij vendimi apo legjislacionit të fuqi.
 - Vendndodhja në treg apo pajisja lihet në shfrytëzim një subjekti tjetër i cili është i paautorizuar.
2. Në këtë rast organi inspektues vepron në përputhje me parashikimet e pikës 10.3; 10.4; 10.5 dhe 10.6 të Kreut I, të kësaj VKB-je.